



RISI: Materiale për mësimin në gjuhën e prejdardhjes (MGJP/GJKA)



Qendra IPE e Shkollës së Lartë Pedagogjike të Cyrihut boton një seri 6-pjesëshe të materialeve për MGJP (Udhëheqës i projektit: Prof. Dr. Dr. Basil Schader). Tekstet dalin në shqip, gjermanisht, boshnjakisht/serbisht/kroatisht, turqisht, portugalisht dhe anglisht. Materialet janë konceptuar për mësuesit/et, të cilët duan të ngrejnë cilësinë e mësimin të tyre në gjuhën e prejdardhjes, si dhe ta ndërlidhin më mirë me mësimin e rregullt. Këto materiale u drejtohen edhe të gjitha institucioneve, të cilat janë përgjegjëse për MGJP. Materialet përfshijnë 6 pjesë: Një Doracak – dhe libër pune (rreth 185 f.). Ky libër paraqet

pikat thelbësore të pedagogjisë aktuale, didaktikës dhe metodikës dhe ilustron nëpërmjet shembujve konkretë nga MGJP. Pesë Fletore me nxitje didaktike (rreth 64–88 f.). Mësuesit/et marrin këtu nxitje të mira konkrete, të zbatueshme dhe të provuara praktikisht, për fushat kryesore të mësimin në gjuhën e prejdardhjes.

Botimi shqip parashikohet të dalë në vitin 2016, mbi mundësitë e porosisë, nga marsi do të informojë Qendra IPE e SHLP e Cyrihut (<http://www.phzh.ch/ipe>; Mail: ipe@phzh.ch).